



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 177

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 21 tetor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 106/2024, datë 3.10.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi bashkëpunimin teknik 2022, për projektin “Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri”.....	20227
Dekret i Presidentit nr. 358, datë 16.10.2024	Për shpallje ligji.....	20233
Vendim i Kuvendit nr. 97/2024, datë 17.10.2024	Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga përfaqësuesit e shoqërisë civile sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.....	20233
Vendim i Kuvendit nr. 98/2024, datë 17.10.2024	Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.....	20233
Vendim i Kuvendit nr. 99/2024, datë 17.10.2024	Për mosmiratimin e kandidaturës së zotit Pajtim Melani si anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e kryetarit të Bordit.....	20234
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 17.9.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë në gjykimin e çështjes civile nr. 21001-00016-00-2017, datë regjistrimi 4.1.2017. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë në gjykimin e çështjes nr. 9/5 akti, datë 18.9.2020, me objekt: “Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë etj.” në Gjykatën e Lartë. Konstatimin e shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj.	

Pas konstatimit të shkeljeve veçmas dhe së bashku, caktimin e një shpërblimi të drejtë në referim të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Olivieri dhe të tjerë kundër Italisë*, datë 25.2.2016. Detyrimin e Këshillit të Ministrave për të siguruar ekzekutimin e vendimit të dhënë me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore ose, nëse shihet e nevojshme nga Gjykata Kushtetuese, caktimin e organit të ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit.....

**LIGJ**
Nr. 106/2024**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN
TEKNIK 2022, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI PËR NJË ZHVILLIM
URBAN REZISTENT NDAJ
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2022, për projektin “Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.10.2024.

Shpallur me dekretin nr. 358, datë 16.10.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN
TEKNIK 2022

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe mjedisor në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar bisedimeve qeveritare mes Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 13 dhjetor 2022,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Në zbatim të Marrëveshjes së datës 21 tetor 1988, mbi Bashkëpunimin Teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, do të mbështetet projekti i mëposhtëm “Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1 shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë të përgjithshme deri gjithsej 3.000.000,00 euro (me fjalë: tre milionë euro). Ajo ngarkon me zbatimin e projektit të përmendur në paragrafin 1 Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft Für Internationale Zusammenarbeit – GIZ*).

3. Kjo marrëveshje vlen edhe për shtesa fondesh – si dhe për bashkëfinancime nga donatorë të tjerë – për projektin e përmendur në paragrafin 1, sikundër edhe për masa të tjera vijuese, nëse të dyja qeveritë do të duan të mbështesin më tej këtë projekt.



Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për masa vijuese dhe shtesa fondesh për projekte, bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje. Në këto raste vlejné afate të ndryshme nga neni 2, paragrafi 2, të cilave do t'u referohet specifikisht njoftimi i Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

Neni 2

1. Hollësitë e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, të cilat do të lidhen ndërmjet institucioneve në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2, dhe atyre institucioneve, të cilat do të ngarkohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton, që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejné shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1. Në mënyrë të veçantë, ai garanton edhe për shërbimet partnere të përcaktuara konkretisht në kontratat e zbatimit dhe eventualisht ato të financimit.

2. Premtimet financiare për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda pesë vjetëve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit të përmendura në paragrafin 1. Për këto shuma, afati përfundon me mbarimin e datës 31 gusht 2027. Nëse kontratat e përmendura në paragrafin 1 lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 3

1. Dispozitat e Marrëveshjes Kuadër të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, vlejné edhe për këtë marrëveshje.

2. GIZ-i përjashtohet nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, apo në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2,

paragrafi 1. Zbatim gjen Marrëveshja e datës 6 prill 2010, “Për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe evazionit fiskal për taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin”, në versionin e vlefshëm të secilës palë.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përjashton materialet e importuara me porosi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë – përfshirë këtu pajisjet dhe automjetet – nga të gjitha detyrimet e importit dhe të eksportit, detyrimet portuale dhe të magazinimit, si dhe nga taksat e tjera publike, sikurse garanton zhdoganimin e tyre pa vonesë.

4. Në përputhje me Marrëveshjen Kuadër të datës 21 tetor 1988, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton nga TVSH-ja, apo tatime të ngjashme indirekte të vendosura në Republikën e Shqipërisë, materialet e siguruara apo shërbimet e shfrytëzuara nga organizata gjermane zbatuese, në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1. Përjashtimi prej këtyre detyrimeve mund të kryhet në formën e rimbursimit, apo të heqjes së këtyre taksave.

Neni 4

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda-shtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë në çdo kohë me shkrim në rrugë diplomatike. Zgjidhja e Marrëveshjes bëhet efektive ditën e parë të muajit, që vijon pas një periudhe dymbëdhjetëmujore, llogaritur prej ditës së mbërritjes së notës zyrtare.

3. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bëre në Tiranë, më 12.7.2024, në dy origjinalë, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Federale
të Gjermanisë



Abkommen

zwischen

dem Ministerrat der Republik Albanien

und

der Regierung der Bundesrepublik Deutschland

über

Technische Zusammenarbeit

2022

Der Ministerrat der Republik Albanien

und

die Regierung der Bundesrepublik Deutschland –

im Geiste der bestehenden freundschaftlichen Beziehungen zwischen der Republik Albanien und der Bundesrepublik Deutschland,

in dem Wunsch, diese freundschaftlichen Beziehungen durch partnerschaftliche Technische Zusammenarbeit zu festigen und zu vertiefen,

in dem Bewusstsein, dass die Aufrechterhaltung dieser Beziehungen die Grundlage dieses Abkommens ist,

in der Absicht, zur sozialen, wirtschaftlichen und umweltgerechten Entwicklung in der Republik Albanien beizutragen,

unter Bezugnahme auf die Regierungsverhandlungen zwischen der Regierung der Bundesrepublik Deutschland und dem Ministerrat der Republik Albanien vom 13. Dezember 2022

sind wie folgt übereingekommen:

Artikel 1

(1) In Ausführung des Abkommens über Technische Zusammenarbeit zwischen der Regierung der Bundesrepublik Deutschland und dem Ministerrat der Republik Albanien über technische Zusammenarbeit vom 21. Oktober 1988 wird das folgende Vorhaben gefördert:

„Programm für klimaresiliente Stadtentwicklung in Albanien (GCF)“



wenn nach Prüfung die Förderungswürdigkeit dieses Vorhabens festgestellt worden ist.

(2) Die Regierung der Bundesrepublik Deutschland stellt für das in Absatz 1 genannte Vorhaben Personal- und Sachleistungen sowie gegebenenfalls Finanzierungsbeiträge im Gesamtwert von bis zu 3 000 000 Euro (in Worten: drei Millionen Euro) zur Verfügung. Sie beauftragt mit der Durchführung des in Absatz 1 genannten Vorhabens die Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

(3) Dieses Abkommen gilt auch für Aufstockungen – sowie Kofinanzierungen anderer Geber – des in Absatz 1 genannten Vorhabens und künftige Folgevorhaben, sofern beide Regierungen die Förderung weiterführen wollen. Förderzusagen der Regierung der Bundesrepublik Deutschland für Folgevorhaben und Aufstockungen für Vorhaben erfolgen durch Mitteilung der Regierung der Bundesrepublik Deutschland, die auf dieses Abkommen ausdrücklich Bezug nimmt. In diesen Fällen gelten von Artikel 2 Absatz 2 abweichende Fristen, auf die in der Mitteilung der Regierung der Bundesrepublik Deutschland gesondert hingewiesen wird.

Artikel 2

(1) Einzelheiten des in Artikel 1 Absatz 1 genannten Vorhabens und der zu erbringenden Leistungen und Verpflichtungen sollen in Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträgen festgelegt werden, die zwischen den nach Artikel 1 Absatz 2 und den von dem Ministerrat der Republik Albanien mit der Durchführung des Vorhabens noch zu beauftragenden Institutionen geschlossen werden. Der Ministerrat der Republik Albanien stellt sicher, dass die von ihm mit der Durchführung beauftragten Institutionen die für das in Artikel 1 Absatz 1 genannte Vorhaben notwendigen Leistungen erbringen. Insbesondere stellt sie die in den Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträgen konkretisierten Partnerleistungen sicher.

(2) Die Zusage für das in Artikel 1 Absatz 1 genannte Vorhaben entfällt ersatzlos, soweit nicht innerhalb von fünf Jahren nach der Zusage die in Absatz 1 genannten



Durchführungsverträge geschlossen werden. Für diese Beträge endet die Frist mit Ablauf des 31. August 2027. Sollten nur für einen Teil der Zusagen in dem vorgesehenen Zeitraum die in Absatz 1 genannten Verträge geschlossen worden sein, so gilt diese Verfallsklausel nur für die noch nicht durch diese Verträge gebundenen Teilbeträge.

Artikel 3

(1) Die Bestimmungen des in Artikel 1 Absatz 1 genannten Rahmenabkommens gelten auch für dieses Abkommen.

(2) Die GIZ ist von direkten Steuern, die im Zusammenhang mit dem in Artikel 1 Absatz 1 genannten Vorhaben oder dem Abschluss und der Durchführung der in Artikel 2 Absatz 1 genannten Verträge in der Republik Albanien erhoben werden, befreit. Das „Abkommen vom 6. April 2010 zwischen der Bundesrepublik Deutschland und der Republik Albanien zur Vermeidung der Doppelbesteuerung und der Steuerverkürzung auf dem Gebiet der Steuern vom Einkommen und vom Vermögen“ in der jeweils gültigen Fassung findet Anwendung.

(3) Der Ministerrat der Republik Albanien nimmt die im Auftrag der Regierung der Bundesrepublik Deutschland eingeführten Sachgüter, einschließlich Geräten und Fahrzeugen, von sämtlichen Ein- und Ausfuhrabgaben, Hafen- und Lagergebühren sowie von sonstigen öffentlichen Abgaben aus und stellt die unverzügliche Freigabe sicher.

(4) Der Ministerrat der Republik Albanien stellt nach Maßgabe des Rahmenabkommens vom 21. Oktober 1988 die von der deutschen Durchführungsorganisation im Zusammenhang mit dem in Artikel 1 Absatz 1 genannten Vorhaben beschafften Sachgüter und in Anspruch genommenen Dienstleistungen von Umsatzsteuern oder ähnlichen indirekten Steuern frei, die in der Republik Albanien erhoben werden. Die Freistellung kann im Wege einer Erstattung oder einer Befreiung von diesen Steuern erfolgen.



Artikel 4

(1) Dieses Abkommen tritt an dem Tag in Kraft, an dem der Ministerrat der Republik Albanien der Regierung der Bundesrepublik Deutschland mitgeteilt hat, dass die innerstaatlichen Voraussetzungen für das Inkrafttreten erfüllt sind. Maßgebend ist der Tag des Eingangs der Mitteilung.

(2) Dieses Abkommen wird auf unbestimmte Zeit geschlossen. Jede Vertragspartei kann es jederzeit schriftlich auf diplomatischem Wege kündigen. Die Kündigung wird am ersten Tag des Monats wirksam, der auf einen Zeitabschnitt von zwölf Monaten nach Eingang der Notifikation folgt.

(3) Streitigkeiten über die Auslegung oder Anwendung dieses Abkommens werden durch die Vertragsparteien gütlich im Rahmen von Gesprächen beziehungsweise Verhandlungen beigelegt.

Geschehen zu *Tiranë* am *12.7.2024* in zwei Urschriften, jede in albanischer und deutscher Sprache, wobei jeder Wortlaut gleichermaßen verbindlich ist.

Für den Ministerrat der
Republik Albanien

Für die Regierung der
Bundesrepublik Deutschland



DEKRET

Nr. 358, datë 16.10.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 106/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi bashkëpunimin teknik 2022 për projektin ‘Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 97/2024

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NGA PËRFAQËSUESIT E SHOQËRISË
CIVILE, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatin e listës së tretë në bllok për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Violanda Theodhori.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 17.10.2024.

VENDIM
Nr. 98/2024

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË NGA PËRFAQËSUESIT
E SHOQËRISË CIVILE, SIPAS LIGJIT
NR. 115/2016, “PËR ORGANET E
QEVERISJES SË SISTEMIT TË
DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatin e listës së tretë në bllok për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erion Fejzulla.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 17.10.2024.

**VENDIM
Nr. 99/2024****PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZOTIT PAJTIM
MELANI SI ANËTAR I BORDIT TË
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE, QË DO TË MBAJË
FUNKSIONIN E KRYETARIT
TË BORDIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zotit Pajtim Melani si anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e kryetarit të Bordit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Elisa Spiropali**

Datë 17.10.2024.

**VENDIM
Nr. 58, datë 17.9.2024****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

Faqe | 20234

me sekretare Belma Lleshi, më datë 17.9.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 11 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Alida Gazidedja

SUBJEKT I INTERESUAR: Leonard Toçi

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë në gjykimin e çështjes civile nr. 21001-00016-00-2017, datë regjistrimi 4.1.2017.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë në gjykimin e çështjes nr. 9/5 akti, datë 18.9.2020 me objekt: “Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjyqimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë etj.” në Gjykatën e Lartë.

Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj.

Pas konstatimit të shkeljeve veçmas dhe së bashku, caktimi i një shpërblymimi të drejtë në referim të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Olivieri dhe të tjerë kundër Italisë*, datë 25.2.2016.

Detyrimi i Këshillit të Ministrave për të siguruar ekzekutimin e vendimit të dhënë me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore ose, nëse shihet e nevojshme nga Gjykata Kushtetuese, caktimi i organit të ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1–399/12, 474 dhe 475 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi



mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja dhe shtetasi Leonard Toçi kanë lidhur martesë më datë 4.7.2000, gjatë së cilës, më datë 15.1.2005, ka ardhur në jetë fëmija i tyre Brooklyn Toçi. Më datë 4.11.2010, Leonard Toçi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim kërkueses, caktimin e detyrimit të tij ushqimor në masën 10.000 lekë në muaj, si dhe përcaktimin e mënyrës së takimit të tij me të birin dy herë në muaj, gjatë pushimeve të verës e festave të fundvitit.

2. Me vendimin nr. 1982, datë 2.3.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, zgjidhjen e martesës midis Leonard Toçit dhe kërkueses, mbajtjen nga kjo e fundit të mbiemrit që ka pasur përpara martesës, lënien e fëmijës Brooklyn Toçi për rritje dhe edukim Leonard Toçit, detyrimin e kërkueses të paguajë detyrimin ushqimor në favor të fëmijës së saj Brooklyn Toçi në masën 20.000 lekë në muaj, përcaktimin e së drejtës së kërkueses për të takuar dhe mbajtur fëmijën çdo të shtunë nga ora 17:00 deri në orën 12:00 të ditës së diel, si dhe për periudhën e pushimeve verore 16–31 gusht të çdo viti.

3. Ndaj vendimit të gjykatës së rrethit kërkuesja ka ushtruar ankim, duke pretenduar, ndër të tjera, se me vendim të gjykatës së Bolzanos, Itali është vendosur zgjidhja e martesës dhe e pasojave të saj; lënia e fëmijës Brooklyn Toçi në kujdesin e saj; njohja e së drejtës së Leonard Toçit të takohet disa herë me të birin; detyrimi i ish-bashkëshortit për të paguar kontributin për mbajtjen e fëmijës. Ky vendim ka marrë formë të prerë përpara se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të jepte vendimin e saj. Po sipas kërkueses, kjo gjykatë ka disponuar tej objektit të padisë, pasi Leonard Toçi kishte kërkuar që fëmija t'i lihej asaj për rritje dhe edukim. Po kështu, gjykata e ka detyruar të paguajë detyrimin ushqimor, kur gjatë gjykimit është provuar se ishte ajo që e mbante fëmijën.

4. Me vendimin nr. 1570, datë 3.7.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të

vendimit të gjykatës së rrethit për sa i përket zgjidhjes së martesës, si dhe prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për sa i përket rregullimit të pasojave për fëmijën Brooklyn Toçi.

5. Për rekursin e ushtruar nga kërkuesja, me vendimin nr. 97, datë 23.3.2016, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykata e apelit nuk e kishte marrë në konsideratë ekzistencën e vendimit civil të gjykatës italiane, me të cilin ishte disponuar më parë për të njëjtat kërkitime si në çështjen e gjykuar.

6. Në rigjykim, me vendimin nr. 2083, datë 17.10.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1982, datë 2.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj.

7. Kundër vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit Tiranë kërkuesja ka ushtruar rekurs më datë 16.11.2016, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 4.1.2017 me nr. 21001-00016-00-2017, ndërsa shtetasi Leonard Toçi ka paraqitur kundërrekurs.

8. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë, më datë 2.9.2020 kërkuesja i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm e përsheptimin e procedurës së gjykimit, nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, të çështjes së regjistruar më datë 4.1.2017, si dhe urdhërimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të procedonte brenda një afati të arsyeshëm për shqyrtimin e saj. Kjo kërkesë i është kthyer kërkueses pa veprim me shkresën nr. 1920/1, datë 9.9.2020, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, me argumentin se, sipas nenit 474 të KPC-së, ajo duhej nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i saj.

9. Më datë 18.9.2020, kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurës së gjykimit të çështjes, të nënshkruar prej saj dhe mbrojtësit të saj.

10. Me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak se Kolegji tjetër Civil i kësaj gjykate, i cili kishte në shqyrtim çështjen nr. 21001-00016-00-2017 të Regjistrat Themeltar, kishte



caktuar datën 20.9.2023 për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit.

11. Në lidhje me themelin e çështjes, me vendimin nr. 00-2023-3458 (512), datë 20.9.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2083, datë 17.10.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues.

12. Më datë 13.3.2024, kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 4.4.2024. Kolegji i Gjykatës më datë 24.5.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Më datë 17.9.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës së një gjyqtari kushtetues për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. *Kërkesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

13.1 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi:

13.1.1 Rekursi është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë pas 6 vjetësh, 8 muajsh e 17 ditësh nga data e regjistrimit të tij, në shkelje të nenit 399/2, shkronja “b”, të KPC-së.

13.1.2 Kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë pas 2 vjetësh, 10 muajsh e 25 ditësh nga data e paraqitjes së saj, në shkelje të nenit 399/7, pika 2, të KPC-së, që parashikon afatin 45-ditor për shqyrtimin e saj.

13.1.3 Për çështjen me objekt zgjidhjen e martesës nuk ka ende një vendim përfundimtar nga gjykatat e zakonshme, ndonëse kanë kaluar përafërsisht 13 vjet e 4 muaj nga paraqitja e kërkesëpadisë. I biri, i mitur gjatë gjykimit e tashmë madhor, ka qëndruar dhe vijon të qëndrojë me të në Itali. Pavarësisht kërkesave të saj për shqyrtimin e rekursit dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm e përshpejtimin e gjykimit të tij, Gjykata e Lartë e ka shtyrë disa herë shqyrtimin e tyre. Në kohëzgjatjen e afatit të arsyeshëm të gjykimit nuk kanë ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara

në nenin 399/2 të KPC-së dhe argumentet e Gjykatës së Lartë në lidhje me reformën në drejtësi ose procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk përbëjnë shkaqe justifikuese për tejkalimin e afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes.

13.2 *Së drejtës së aksesit*, për shkak të kthimit pa veprime nga kancelari i Gjykatës së Lartë të kërkesës së saj për përshpejtimin e procedurave drejtuar kësaj gjykate më datë 2.9.2020. Neni 57 i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar parashikon se në rastet kur rekursi nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, gjyqtari me vendim njofton palën që të ndreqë të metat e tij brenda 7 ditëve. Në rastin e saj nuk ka pasur një vendim të tillë nga një gjyqtar. Edhe sipas nenit 154/a, paragrafi i tretë, të KPC-së, kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm. Për më tepër, sipas përcaktimeve të nenit 399/5 të KPC-së, kërkesa mund të bëhet nga vetë kërkuesi dhe prokura është e nevojshme vetëm nëse kërkesa bëhet nga avokati.

13.3 *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi, në kundërshtim me nenin 399/6 të KPC-së, i cili parashikon se kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave drejtuar Gjykatës së Lartë shqyrtohet nga një kolegji tjetër i kësaj gjykate, gjyqtari i Gjykatës së Lartë E.P. ka qenë njëkohësisht pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm e përshpejtimin e procedurave të gjykimit dhe e trupit gjykues që ka shqyrtuar rekursin e saj për çështjen e themelit.

13.4 *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi në dhënien e vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023, Gjykata e Lartë ka bërë interpretim të ligjit, duke marrë një rol që nuk i ishte kërkuar. Asaj i ishte kërkuar zbatimi i nenit 399/7, pika 2, të KPC-së dhe nëse gjatë shqyrtimit të çështjes ajo ka vënë në diskutim çështje të ligjit, referuar nenit 473/a të KPC-së duhet të kishte njoftuar palët nëse donte të njëjonte ose ndryshonte praktikën gjyqësore, duke vepruar në përputhje me detyrimet e lindura nga ky nen dhe nenet 481 e vijues të KPC-së.

13.5 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi:

13.5.1 Në vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, Gjykata e Lartë ka referuar kërkesë të regjistruar me tjetër numër dhe tjetër datë. Po kështu, ajo ka



arsyetuar se rekursi i saj është regjistruar në vitin 2012 dhe se çështja gjykohet me 5 gjyqtarë të saj, ndërkohë që rekursi është regjistruar në vitin 2017 dhe është çështje që gjykohet me 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë i është referuar kërkujes në vendim si palë paditëse, ndërkohë që ajo ka qenë e paditur në gjykim. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkujesja ka paraqitur kërkesë për përshpejtim më datë 13.7.2021, ndërkohë që ajo nuk ka paraqitur kërkesë të tillë, por kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë të rekursit të saj të datës 4.1.2017. Gjykata e Lartë ka gabuar kur ka arsyetuar se çështja e themelit është marrë në shqyrtim, pasi në momentin e dhënies nga kjo gjykatë të vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023 nuk ka pasur vendimmarrje të saj për themelin e çështjes dhe një vendim i tillë është marrë më datë 20.9.2023.

13.5.2 Për kërkesën e saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit në zbatim të nenit 399/7, pika 3, të KPC-së, ndërkohë që nuk ka vepruar brenda afatit 30-ditor që përcakton kjo dispozitë dhe nuk ka dhënë asnjë argument për shkeljen e afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

13.5.3 Ndërsa referon në garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, në vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023 Gjykata e Lartë ka lënë pa përgjigje nëse ajo vetë e ka zbatuar atë. Në vendim ajo ka përdorur shprehjet “kosto”, “afate”, “vështirësi”, “proporcionalitet” e “padyshim”, pa treguar asnjë metodologji të zbatueshme se çfarë do të thotë “tejzgjatje e afateve” ose “pamundësi objektive”.

13.5.4 Në vendimin për vlerësimin e rekursit Gjykata e Lartë nuk ka parashtruar asnjë argument në lidhje me shkeljen prej saj të nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së.

13.6 Sipas shpalljes në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, gjyqtari E.P. i kësaj gjykate, i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm e përshpejtimin e procedurave, në të njëjtën datë e orë me shqyrtimin e kërkesës së saj ka shqyrtuar një tjetër kërkesë të ngjashme, çka bën të paqartë se si i njëjti gjyqtar mund të marrë pjesë në dy seanca gjyqësore njëkohësisht.

13.7 Së drejtës për dëshmipërblim, si rrjedhojë e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

14. *Subjekti i interesuar*, Leonard Toçi, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata nëpërmjet njoftimit me shpallje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkujeses

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata vëren se kërkujesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të



atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 11, datë 28.2.2024; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas Gjykatës, si rregull, për sa i përket cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes ose zvarritjes së procedurave, mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave i përket gjyqësorit të zakonshëm, ndërkohë që ajo investohet vetëm për riparimin e shkeljeve të kryera nga ato gjykata, në rast se ato nuk janë në gjendje të korrigjojnë dhe riparojnë shkeljen e së drejtës për proces të rregullt, pra në rast se provohet se mjeti juridik nuk ka qenë efektiv. Në këtë drejtim, vetë individit duhet të tregojë kujdesin e duhur, duke përdorur në kohën e duhur mjetin juridik parandalues/përshpejtues, konkretisht kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 11, datë 28.2.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të neneve 399/5 - 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit të regjistruar në atë gjykatë, kërkesë për të cilën gjykimi është pushuar nga Kolegji Civil i asaj gjykate me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023. Në ankimin kushtetues individual kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm për sa i përket: (i) kohëzgjatjes së shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të rekursit të paraqitur prej saj; (ii) kohëzgjatjes së shqyrtimit nga kjo gjykatë të kërkesës së saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm e përshpejtimin të procedurës së gjykimit të rekursit; (iii) kohëzgjatjes së procesit gjyqësor në tërësi. Kërkesja ka pretenduar, gjithashtu, edhe mungesën e efektivitetit të mjeteve të reja juridike të parashikuara nga KPC-ja, me argumentin se ky mekanizëm nuk jep mundësinë e konstatimit të shkeljeve në rastet e tejzgjatjes së procedurave dhe atë të shpërbërimit të dëmit për këtë shkak.

20. Gjykata ka theksuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti “parandalues ose përshpejtues”, i projektuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti “riparues, kompensues ose monetar” që parashikon

korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë nëse procedura është ende në shqyrtim apo nuk ka përfunduar ende. Ligjvënësi ka bërë një parashikim për një zgjidhje përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, efikasiteti i përgjithshëm i së cilës, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, është vlerësuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke arritur në përfundimin se zgjidhja për përshpejtimin e procedurave dhe ofrimin e kompensimit është efikase, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih vendimet nr. 11, datë 28.2.2024; nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se fillimisht më datë 2.9.2020 e më pas më datë 18.9.2020 kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të rekursit të saj. Po kështu, sipas informacionit të vënë në dispozicion nga kërkesja, Gjykata konstaton se më datë 25.10.2021, përmes faqes së saj zyrtare, Gjykata e Lartë ka njoftuar për shqyrtimin e kërkesës së kërkeses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të rekursit fillimisht më datë 3.11.2021. Po në këtë datë ajo ka njoftuar shtyrjen e shqyrtimit të çështjes për një datë tjetër, ndërsa më datë 12.7.2023 ka njoftuar për shqyrtimin e saj më datë 26.7.2023, datë kur dhe ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se kishte caktuar datën 20.9.2023 për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

22. Gjykata vlerëson se, në përputhje me standardet kushtetuese dhe parashikimet ligjore, kërkesja ka përdorur mjetet juridike në dispozicion të saj për përshpejtimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, përmes paraqitjes së kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të rekursit të saj. Në lidhje me këtë kërkesë, e cila nuk rezulton të ketë qenë formale, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, duke vendosur pushimin e gjykimit. Duke pasur parasysh se vendimi për këtë kërkesë është dhënë nga Gjykata e Lartë pas më shumë se 2 vjetësh e 10 muajsh, faktin se çështja e themelit është kthyer për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm



Tiranë, si dhe standardin kushtetues të garantuar nga neni 13 i KEDNJ-së për shqyrtimin pa vonesa të tepërta të çështjeve të kësaj natyre dhe garantimin e korrigjimit të tyre përmes përsheptimit të procedurave ose ofrimit të kompensimit, Gjykata çmon se mjetet juridike në dispozicion të kërkuës nuk rezultojnë të kenë qenë efektive për sa i përket përsheptimit të procedurave të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Po kështu, në kushtet kur kërkuësja ka ezauruar mjetin juridik në dispozicion të saj për përsheptimin e gjykimit të rekursit dhe në lidhje me të Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka më mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

23. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, Gjykata konstaton se, sipas shkresës nr. 5928/1 prot., datë 20.11.2023 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, vendimi i kësaj gjykate për pushimin e gjykimit të çështjes së kërkuës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave është depozituar i arsyetuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Lartë më datë 16.11.2023 dhe i është komunikuar kërkuës më datë 21.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 13.3.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi shkelja e pretenduar është vazhduese dhe ankimi kushtetues individual, pas shterimit të mjetit juridik në dispozicion, është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

24. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, së drejtës së aksesit, parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe së drejtës për dëmshpërblim. Për sa i takon kësaj të fundit, Gjykata thekson se e drejta për dëmshpërblim i lind kërkuës pas konstatimit të shkeljes dhe ajo duhet ta ushtrojë atë pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, Gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim këtë pretendim të saj, ndaj çmon se në lidhje me të kërkuësja nuk legjitimohet *ratione materiae*. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson se *prima facie* ato përfshihen në juridiksionin e saj.

25. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit si rrjedhojë e veprimeve të kancelarit të Gjykatës së Lartë për kthimin pa veprim të kërkesës së saj të parë drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes nga kjo gjykatë të afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përsheptimin e shqyrtimit të rekursit të saj.

26. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kthimi pa veprim i kërkesave drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e gjykimit nga kancelari i kësaj gjykate bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një mjet pengues të aksesit në Gjykatën e Lartë. Po sipas Gjykatës, veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës). Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përsheptim të mos humbasë qëllimin e vetë dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se pas kthimit pa veprim nga kancelari i Gjykatës së Lartë të kërkesës së datës 2.9.2020, kërkuësja e ka paraqitur sërish atë më datë 18.9.2020, të nënshkruar tashmë nga përfaqësuesi i saj ligjor dhe pas shqyrtimit të saj, me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se veprimet e kancelarit nuk rezultojnë të kenë qenë një faktor shtesë që ka ndikuar në vonesat e shkaktuara në shqyrtimin e kërkesës së kërkuës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave. Nga ana tjetër, në kushtet kur në lidhje me këtë kërkesë Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, Gjykata çmon se kërkuësja e ka realizuar të drejtën e saj të aksesit në këtë gjykatë, ndaj vlerëson se pretendimet e saj për cenimin e kësaj të drejte nuk janë të argumentuara në këndvështrimin kushtetues.

28. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e gabimeve në



arsyetimin e vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023 të Gjykatës së Lartë.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje e bën procesin të parregullt, në aspektin e cenimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 57, datë 9.11.2023; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mbështetje të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata çmon se pakujdesitë e Gjykatës së Lartë në arsyetimin e vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023 nuk janë të tilla që procesi gjyqësor në tërësinë e tij të vlerësohet i parregullt në këndvështrimin kushtetues.

30. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e shqyrtimit nga gjyqtari E.P., në të njëjtën datë dhe orë me çështjen e saj, edhe të një çështjeje tjetër. Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuësës nuk është argumentuar në aspektin kushtetues në drejtëm të të drejtave kushtetuese që i janë cenuar për këtë shkak.

31. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vlerëson se ai ka të bëjë, në thelb, me procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë në lidhje me kërkesën e kërkuësës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e shqyrtimit të rekursit të saj.

32. Për sa më lart, duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata çmon t'i analizojë ato në vijim në drejtëm të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

33. Kërkuësja ka pretenduar se rekursi i saj është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë pas 6 vjetësh, 8 muajsh e 17 ditësh nga data e regjistrimit të tij, në shkelje të nenit 399/2, shkronja “b”, të KPC-së, ndërsa kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurës së gjykimit pas 2 vjetësh, 10 muajsh e 25 ditësh nga data e paraqitjes së saj, në shkelje të nenit 399/7, pika 2, të KPC-së, që parashikon afatin 45-ditor për shqyrtimin e saj. Për çështjen me objekt zgjidhjen e martesës nuk ka ende një zgjidhje përfundimtare nga

gjykatat e zakonshme, ndonëse kanë kaluar për afërsisht 13 vjet e 4 muaj nga paraqitja e kërkesëpadisë. I biri, i mitur gjatë gjykimit e tashmë madhor, ka qëndruar dhe vijon të qëndrojë me të në Itali. Po sipas kërkuësës, në kohëzgjatjen e afatit të arsyeshëm të gjykimit nuk kanë ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së. Argumentet e Gjykatës së Lartë në lidhje me reformën në drejtësi ose procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk përbëjnë shkaqe justifikuese të tejkalimit të afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes. Kjo gjykatë ka vendosur pushimin e gjykimit në zbatim të nenit 399/7, pika 3, të KPC-së, ndërkohë që nuk ka vepruar brenda afatit 30-ditor që përcakton kjo dispozitë dhe nuk ka dhënë asnjë argument për shkeljen e afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së. Shprehjet e përdorura në vendim nuk shpjegojnë se çfarë do të thotë “te zgjatje e afateve” ose “pamundësi objektive”.

34. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përfshihen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 27, datë 11.4.2024; nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret Gjykata konstaton se thelbi i mosmarrëveshjes që po gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me rregullimin e pasojave si rrjedhojë e zgjidhjes së martesës mes kërkuësës dhe ish-bashkëshortit të saj, konkretisht për sa u përket detyrimeve prindërore në lidhje me fëmijën Brooklyn Toçi. Ky proces është iniciuar nga ish-bashkëshorti i kërkuësës në fund të vitit 2010, ndërkohë që fëmija ka mbushur moshën madhore në janar të vitit 2023. Rekursi i kërkuësës kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes të cilit është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili zgjidhte martesën duke i lënë fëmijën për rritje dhe edukim ish-bashkëshortit të saj, është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë



4.1.2017. Më datë 2.9.2020 kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, e cila i është kthyer administrativisht nga kancelari i kësaj gjykate, për shkak të mosnënshkrimit të saj nga avokati. Në vijim, kërkesja e ka riparaqitur këtë kërkesë më datë 18.9.2020, të nënshkruar tashmë nga përfaqësuesi ligjor i saj. Me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit, për shkak se Kolegji tjetër Civil i kësaj gjykate, i cili kishte në shqyrtim rekursin e kërkeses, kishte caktuar datën 20.9.2023 për shqyrtimin e tij në dhomën e këshillimit. Në përfundim të shqyrtimit të rekursit, me vendimin nr. 00-2023-3458 (512), datë 20.9.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2083, datë 17.10.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues. Sipas shkresës nr. 16207/1 prot., datë 12.9.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, çështja është shortuar më datë 31.10.2023 dhe seanca gjyqësore për shqyrtimin e saj është caktuar më datë 30.9.2024.

36. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes civile, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së). Kjo nënkupton se, formalisht, gjykimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, i cili ka zgjatur mbi 6 vjet e 8 muaj, ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

37. Në këtë drejtim, Gjykata ka konstatuar tashmë se gjatë gjykimit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të afatit, vonesa në gjykim është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit kushtetues që ka

përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 61, datë 20.11.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në vështtrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkeses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkeses; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkesja (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në lidhje me *sjelljen e kërkeses* Gjykata vëren se pasi është njohur me vendimin nr. 2083, datë 17.10.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit që ka zgjidhur martesën, duke përcaktuar ish-bashkëshortin si kujdestar të fëmijës dhe detyrimin e saj për të paguar detyrimin ushqimor, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs më datë 6.11.2016. Pas regjistrimit të çështjes në këtë gjykatë, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së, fillimisht më datë 2.9.2020 e më pas më datë 18.9.2020 kërkesja i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në shqyrtimin e rekursit dhe përshpejtimin e procedurave. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 9/5, datë 26.7.2023, në analizë të të cilit Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë konstatuar kohëzgjatje të procesit, për shkak të sjelljes së kërkeses. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

40. Për sa i takon *kompleksitetin të çështjes* në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i çështjes dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme.



Në këtë kuptim, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit (*shih vendimet nr. 27, datë 11.4.2024; nr. 46, datë 3.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në rastin konkret, Gjykata eidenton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje më datë 4.1.2017 për shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të faktit, të cilat kanë vendosur pranimin e kërkesëpadisë së bashkëshortit të saj për zgjidhjen e martesës dhe të pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e saj për sa i përket fëmijës që ai ka me kërkuesen. Palë në proces kanë qenë vetëm kërkuesja e ish-bashkëshorti i saj dhe çështja nuk rezulton të ketë qenë komplekse ose të ketë pasur volum të lartë aktesh provuese, çka mund të ndikonte në kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se çështja nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat në gjykimin e rekursit prej më shumë se 6 vjetësh e 8 muajsh.

42. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, në vendimin për pushimin e gjykimit të kërkesës së kërkueses për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave, Gjykata e Lartë ka evidentuar qëndrimin e gjyqtarit relator se në këtë gjykatë ndodhen për shqyrtim rreth 18.000 çështje civile, të cilat po shqyrtohen sipas regjistrimit, dhe se po shqyrtohen çështje të vitit 2013 që kanë kaluar në seancë gjyqësore, ndërkohë që ka edhe çështje më të hershme, të viteve 2010, 2011 dhe 2012. Gjykata e Lartë ka çmuar se mosveprimi i saj nuk ka ndodhur për shkaqe objektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili është ndërruar disa herë, por si rrjedhojë e situatës aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor për shkak të reformës në drejtësi (*shih paragrafët 22-23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Duke mbajtur në konsideratë këtë qëndrim të Gjykatës së Lartë, faktin se deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e rrethit është mbi 13 vjet e 10 muaj, si dhe faktin se çështja e kërkueses, e kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe e regjistruar në këtë gjykatë më datë 31.10.2023, do të shqyrtohet më datë 30.9.2024, Gjykata vlerëson se sjellja e autoriteteve nuk ka qenë në nivelin e duhur për sa i përket eficiencës së gjykimit.

43. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja*, Gjykata vëren se pretendimet e saj për zgjidhjen e martesës kanë marrë përgjigje me vendimin nr. 1982, datë 2.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të lënë në fuqi për këtë pjesë me vendimin nr. 1570, datë 3.7.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes të cilave është vendosur zgjidhja e saj. Për sa i përket pjesës së rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me kujdestarinë e fëmijës dhe përcaktimit të detyrimit ushqimor, Gjykata eidenton se Brooklyn Toçi rezulton të ketë arritur moshën madhore në janar të vitit 2023, moment ky kur rekursi i kërkueses ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Në këndvështrim të përcaktimeve të kreut II, pika 3.1, shkronja “a”, të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, i cili, deri në momentin e marrjes nga Gjykata e Lartë të vendimit nr. 9, datë 3.6.2024 “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të disa çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Lartë”, gjente zbatim edhe në rastin e kërkueses dhe sipas të cilit çështjet që kishin për objekt të drejta të fëmijës apo që kishin ndikim te një fëmijë i mitur kishin përparësi në gjykim, Gjykata çmon se çështja e kërkueses paraqiste përparësi në shqyrtim në drejtim të interesit që i cenohej asaj si rrjedhojë e tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë.

44. Për sa më sipër, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej kriterëve të mësipërme që janë përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, pasi shqyrtimi prej saj i çështjes ka tejkaluar kufirin kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkueses për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023 të Gjykatës së Lartë duhet të pranohet.

45. Po kështu, Gjykata çmon se konstatimi i shkeljes së kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave prej saj është i mjaftueshëm për përshpejtimin e procedurave nga gjykata që ka kryer shkeljen, duke theksuar se në bazë të nenit 132 të Kushtetutës vendimet e saj janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Për këtë arsye, si dhe duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata çmon se nuk është rasti për të



vendosur në dispozitiv afat kohor për përfundimin e shqyrtimit të çështjes.

46. Duke qenë se vendimi nr. 9/5, datë 26.7.2023 i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet për shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e pretendimeve të kërkuësës për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

47. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuësës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin

e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 9/5, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.9.2024.

Shpallur, më 16.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

